



**REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/
REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E FERIZAJT**



DREJTORIA PËR ZHVILLIM EKONOMIK

THIRRJE PUBLIKE

**Thirrje Publike për Trajnime Falas për Gratë dhe Vajzat në Fushat e
Rrobaqepësisë, Dizajnit, Menaxhimit të Rrjeteve Sociale dhe Gjuhës Angleze**

2025

Autoriteti kontraktues:

KOMUNA E FERIZAJT

Afati për dorëzimin e aplikacioneve:

Nga data 25.04.2025 deri me 12.05.2025

Në kuadër të një nisme për mbështetje dhe zhvillim të bizneseve të grave dhe vajzave të reja, kemi kënaqësinë të shpallim mundësi trajnimi falas për ato që janë të interesuara të përmirësojnë aftësitë dhe profesionet e tyre në **fushat e rrobaqepësisë, dizajnit dhe menaxhimit të rrjeteve sociale, si dhe kursin për zhvillimin e aftësive të gjuhës angleze.**

Kjo është një mundësi e shkëlqyer për t'u profesionalizuar, për të rritur njohuritë dhe për të fituar çertifikata që mund të hapin dyer të reja për zhvillimin e karrierës dhe biznesit tuaj.

Kush mund të aplikojë?

Kjo thirrje publike është për gratë dhe vajzat që janë nga mosha 18 vite dhe :

- Posedojnë biznese të fokusuara në fushën e rrobaqepësisë ose që janë në fazën e start-up-it në këtë fushë.
- Janë të interesuara të zhvillojnë aftësitë e tyre profesionale në dizajn dhe menaxhim të rrjeteve sociale.
- Dëshirojnë të përmirësojnë njohuritë dhe aftësitë e tyre në gjuhën angleze.

Çfarë ofrohet?

- Trajtime falas nga profesionistë të fushave përkatëse, përkatësisht:
 - **Rrobaqepësi:** Trajtime praktike dhe teorike për avancimin e aftësive në prodhimin dhe dizajnimin e rrobave(ky trajnim zgjat 30 dite apo 22 ditë pune)
 - **Dizajn dhe Menaxhim i Rrjeteve Sociale:** Mësime për të krijuar dhe menaxhuar strategji të suksesshme të marketingut dhe komunikimit online.
 - **Gjuhë Angleze:** Kurse për zhvillimin e aftësive të komunikimit në gjuhën angleze Kursi do të zgjatë 1 muaj dhe do të mbahet 3 herë në javë nga 90 minuta.
- Mundësi për të mësuar teknika të reja dhe të avancuara.
- Pas përfundimit të trajnimit, pjesëmarrësit do të pajisen me certifikata.

Si mund të aplikoni?

Të gjitha interesuarat mund të aplikojnë përmes **formularit të aplikimit, i cili mund të gjendet në Qendrën për Shërbime me Qytetarë në katin përdhes të objektit të Komunës së Ferizajt.**

Afati i fundit për aplikim është data 12.05.2025

Mënyra e Përzgjedhjes së Pjesëmarrësve

Përzgjedhja e aplikanteve për trajnimin falas do të bëhet në bazë të disa kritereve të qarta dhe të drejta, duke siguruar që kandidatët më të përshtatshëm të kenë mundësinë të marrin pjesë.

Kriteret e Pjesëmarrësve:

- Kandidatët duhet të jenë gra dhe vajza të reja të cilat synojnë të profesionalizohen edhe më tej në fushat e rrobaqepësisë, dizajnit dhe menaxhimit të rrjeteve sociale, si dhe zhvillimit të aftësive të gjuhës angleze.
- Aplikantët duhet të kenë dëshirë për të zhvilluar aftësitë e tyre profesionale dhe të jenë të gatshëm të angazhohen për gjatë gjithë kohëzgjatjes së trajnimit (30 ditë ose 22 ditë pune).
- Prioritet do t'u jepet atyre që janë të angazhuara në zona më pak të zhvilluara ose në komunitete ku mundësitë për trajnime të tilla janë më të kufizuara.

Procesi i Përzgjedhjes:

1. **Aplikimi:** Kandidatët duhet të plotësojnë formularin e aplikimit dhe ta dorëzojnë pranë Qendrës për Shërbime me Qytetarë në katin përdhës të objektit të Komunës së Ferizajt.
2. **Vlerësimi i Aplikimeve:** Çdo aplikim do të vlerësohet nga një komision i përzgjedhur, i cili do të shqyrtojë informacionin në formularin e aplikimit dhe do të bëjë një analizë të nevojave të aplikantëve.
3. **Përzgjedhja Përfundimtare:** Pas shqyrtimit të aplikimeve, do të bëhet një listë përfundimtare e aplikanteve që do të ftohen të marrin pjesë në trajnim.

Kriteret e Përzgjedhjes:

- Kandidatët do të vlerësohen në bazë të interesimit dhe njohurive të përgjithshme në keto fusha :**rrobaqepësisë, dizajnit dhe menaxhimit të rrjeteve sociale.**
- Aplikantët që tregojnë pasion dhe angazhim për profesionin dhe që janë të gatshëm të aplikojnë teknikat e reja në biznesin e tyre do të kenë përparësi.
- Lista e përzgjedhur e aplikanteve do të bazohet gjithashtu në një ndarje të drejtë, duke pasur parasysh diversitetin dhe përfaqësimin nga zona të ndryshme.

Njoftimi për Rezultatet:

Pjesëmarrësit do të njoftohen përfundimisht për pranimin e tyre në trajnim Brenda **15 dite**.

Ky proces siguron një përzgjedhje të drejtë dhe të qartë, duke mundësuar që ato që janë më të përgatitura dhe të motivuara të kenë mundësinë për të përfituar nga ky trajnim falas.

Për më shumë informacion dhe pyetje, mund të na kontaktoni përmes numrit të telefonit:
038 200 46 010

Ju ftojmë të bëni hapa të rëndësishëm drejt profesionalizimit dhe suksesit tuaj!

Me respekt!

Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit